

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Date 23.12.2022

"GARAGE ZONE LAVAZH" SHPK

Z. Jani Lleshaj, atësia Preng, i datëlindjes 28.08.1974, i lindur në Prosek,Mirdite dhe banues në Rr "Lord Bajron" Nd 017,H 1,Ap 017,Njesia Bashkiane Nr 11 Tirane me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i indentifikuar nga karta e identitetit me nr. 035791203.

I cili mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, "Për shoqëritë Tregtare" dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithesi, ka vendosur si më poshtë:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari private.

Shoqëria është person juridik shqiptar, Veprimtaria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë,Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet "GARAGE ZONE LAVAZH" SH.P.K

Neni 3

Selia e Shoqërisë "GARAGE ZONE LAVAZH" sh.p.k. do të jetë : Rruga "Marubi" Njesia Bashkiake Nr 11,me Nr Pasurie 7/695,Zk.8310,vol.54 faqe 102, Tirane


Neni 4

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose tëshkurtohet me vendim te asamblesë së ortakëve.

Shoqëria "GARAGE ZONE LAVAZH" SH.P.K, gjëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "GARAGE ZONE LAVAZH" sh.p.k. do të jetë:



- Lavazh,parking,makina me qera,etj.

Neni 6

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj ne adresen e shoqerise sipas te gjitha rregullave të cilat mbështeten në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, "Për shoqëritë Tregtare" dhe në legjislacionin shqiptar.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.

Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën 100 Lekë.

Neni 9

Shoqeria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.


Neni 10

Veprimtaria e Shqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me Ligjin Shqiptar ose të huaj.

**Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve
Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore**

Neni 11

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.



- Pjesemarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasie të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrin pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Ti japi shoqërisë informata e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.


Administrimi

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në Shoqërinë “GARAGE ZONE LAVAZH”SH.P.K, Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Jani Lleshaj**. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë “GARAGE ZONE LAVAZH” SH.P.K.

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të



kryer të gjitha veprimet ne interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimitarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Mbyllja e Shoqërisë:

Neni 13

Veprimitaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentable si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijuar të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi.

Kur behet likujdimi

Neni 14


Asambleja e ortakëve emëron likujdatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimitarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likujdimit. Komisioni i likujdimit përbëhet nga një ose tre anetarë. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfytëzimi, shiten në varësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet finaciare të fituara si rezultat i veprimitarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondeve finaciare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të janë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z.Jani Lleshaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Z. Jani Lleshaj". The signature is fluid and cursive, with the initials "Z." and "Jani" on the left and "Lleshaj" on the right.